

Një Standart Global



EITI është një standart global për qeverisjen e burimeve të naftës, gazit dhe minerare të një vendi. Standarti është zbatuar nga qeveritë në bashkëpunim me kompanitë dhe shoqërinë civile.

Vendet të cilat zbatojnë EITI deklarojnë informacion mbi pagesat e taksave, licensave, kontratave, prodhimin dhe elementë të tjerë të rëndësishëm rreth nxjerrjes së burimeve natyrore.

Nxitja e Debatit Publik

Vënia e informacionit në dispozicion të publikut përmirëson debatin rreth menaxhimit dhe përdorimit të burimeve natyrore të një vendi. Drejtuesit mbajnë përgjegjësi për vendimet e tyre.

Qeveritë së bashku me kompanitë dhe shoqërinë civile punojnë për të përmirësuar menaxhimin e burimeve natyrore duke zbatuar standartin EITI



Burimet natyrore të një vendi i përkasin shtetasve të tij

Pasuria nga burimet natyrore mund të çojë në rritjen ekonomike dhe zhvillimin social të një vendi. Mos deklarimi i të dhënave mbi këtë pasuri mund të rrisë rrezikun e mosbesimit, qeverisjes së dobët dhe konfliktit. Deklarimi i mënyrës se si një vend i menaxhon burimet e tij natyrore është i nevojshëm për të siguruar që burimet i përfitojnë të gjithë qytetarët.

Fakte të Rëndësishme, 15 Tetor 2014

48

Shtete zbatuese EITI

1.3 US \$ të ardhura totale

Vlera e deklaruar e të ardhurave të qeverisë nga nafta, gazi dhe mineraleve

31

Janë anëtarë në përputhje me kërkesat EITI

346

Njerëz në mbarë botën punojnë në sekretariatet EITI duke zbatuar EITI-in në baza ditore

207

Vite të përfshira në Raportet EITI

1005

Persona së bashku formojnë 48 koalicionet kombëtare EITI dhe bordin EITI Ndërkombëtar

48 VENDE ZBATOJNË EITI

Për më shumë informacion se si funksionon EITI në shtete, vizitoni eiti.org/countries

Zbatimi EITI sjell një gamë të gjerë të përfitimesh

Qeverisja forcohet

Zbatimi i standartit EITI përmirëson sistemet qeveritare dhe mund të çojë në përmirësimin e grumbullimit të taksave dhe planifikimit buxhetor. Ajo sinjalizon angazhim për menaxhimin transparent dhe të përgjegjshëm të burimeve natyrore të një vendi. Një qeveri transparente dhe e hapur rrit besimin e qytetarëve.

Fakte EITI 2014



Fusha e veprimit

Të gjitha kompanive i kërkohet të deklarojnë të njëjtin informacion – të njëjtat rregulla për të gjitha kompanitë. Kompanitë gjithashtu përfitojnë nga një klimë e qëndrueshme dhe e përmirësuar e investimeve për të cilat ata mund të angazhohen në mënyrë më efektive me qytetarët dhe shoqërinë civile.

Informacion i besueshëm dhe i arritshëm


Qytetarët përfitojnë nga marrja e informacionit të besueshëm në lidhje me burimet natyrore të vendit të tyre dhe për ti mundësuar atyre llogaridhënien nga ana e qeverisë dhe kompanive. Shoqëria civile është një partner thelbësor në zbatimin EITI.

Statusi i vendeve EITI

- Kandidat: Vend zbatues EITI, ende jo një vend anëtar me të gjitha Kërkesat EITI
- Anëtar: E konfirmuar që ka plotësuar të gjitha Kërkesat EITI
- I pezulluar: Statusi Anëtar/Kandidat është pezulluar përkohësisht
- Të Tjera: Disa shtete kanë shfaqur interes në zbatimin EITI

31 Vende anëtare

Shqipëria	Guinea	Nigeria
Azerbaxhani	Indonezia	Norvegjia
Burkina Faso	Irak	Peru
Kamerun	Kazakistan	Kongo
Republika Qëndrore e Afrikës*	Liberia	Sierra Leone
Republika Kirkistanit	Chad	Tanzania
Cote d'Ivoire	Mali	Timor-Leste
DR e Kongos	Mauritania	Togo
Mongolia	Gana	Mozambik
Guatemala	Niger	Zambia
Jemen		*e pezulluar



17 Vende Kandidade

Afganistan	Filipinet	Trinidad and
Kolumbia	Sao Tome and	Tabako
Etiopia	Principe	Ukraina
Honduras	Senegal	Mbreteria e
Madagaskar	Seychelles	Bashkuar
Mianmar	Ishujt Solomon	USA
Papua Guinea e Re	Taxhikistan	

Shtete të tjera

Australia	Gjermania
Franca	Italia

Mbështetësit

Mbi 90 kompani të mëdha të përfshira, në naftë, gaz dhe miniera janë angazhuar për të mbështetur EITI nëpërmjet operacioneve në vendet zbatuese, angazhimet në nivel ndërkombëtar dhe shoqatave të industries. EITI ka fituar mbështetjen e mbi 90 institucioneve të investimeve globale, që së bashku menaxhojnë mbi 19 trilion US \$.

Një koalicion i gjerë i qeverive, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare mbështesin EITI, duke përfshirë 400 organizata jo qeveritare, Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Këshillin Ndërkombëtar për Miniera dhe Metale dhe bankat e zhvillimit rajonal. Këto organizata ofrojnë mbështetje financiare dhe teknike për vendet zbatuese dhe mbështesin shtrirjen EITI.

Për më tepër në www.eiti.org/supporters

SI FUNKSIONON EITI



Për të qënë anëtar EITI, një vend duhet t'i përmbahet standardit EITI.

Standarti EITI parashtron shtatë kërkesa se si të raportohen aktivitetet në sektorët e naftës, gazit dhe minerareve përgjatë zinxhirit të vlerave të nxjerrjes së një burimi, për ta kthyer atë në përfitim publik. I gjithë informacioni është i botuar regullisht në Raportin EITI të një vendi. Një vend i cili angazhohet në përmbushjen e këtij standardi është një shtet “Kandidat”. Një vend ka 2.5 vjet afat nga data e pranimit si një

“Kandidat” për të përmbushur kërkesat. Vendi më pas vlerësohet në mënyrë të pavarur dhe nëse konsiderohet në përputhje me kërkesat EITI për transparencën bëhet vend “Anëtar”. Nga këtu e tutje, vendet vlerësohen në çdo tre vjet dhe mund të pezullohen nga standardi i transparencës në çdo kohë.

7 kërkesat e Standartit EITI:

1. Mbikëqyrje efektive nga Grupi Ndër-Institucional i Punës.
2. Publikimi në kohë i Raporteve EITI.
3. Raporte EITI që përfshijnë informacion kontekstual rreth industrisë nxjerrëse.
4. Paraqitje e hollësishme e raporteve EITI, që përfshijnë deklarinimin e plotë të qeverisë për të ardhurat nga industria nxjerrëse dhe deklarinimin e të gjitha pagesave materiale në qeveri nga kompanitë e naftës, gazit, minerareve.
5. Proçes i sigurtë besueshmërie duke aplikuar standartet ndërkombëtare.
6. Raportet EITI të detajuara, të promovuara në mënyrë aktive, të publikuara dhe që kontribuojnë në debatin public.
7. Grupi Ndër-Institucional i Punës, të ndërmarrë hapa nga mësimet e nxjerra dhe të rishikojnë rezultatet dhe impaktin e zbatimit EITI.

Website: www.eiti.org

Email: secretariat@eiti.org

Telephone: +47 222 00 800

Fax: +47 228 30 802

Address: EITI Secretariat, Ruseløkkveien 26, 0251 Oslo, Norway

Standarti EITI gjendet në:

www.eiti.org/document/standard

Për më shumë vizitoni: www.eiti.org

ose na ndiqni ne Twitter [@EITIOrg](https://twitter.com/EITIOrg)